



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosova  
Kuvendi – Skupština - Assembly

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD

---

**RAPORTI VJETOR**  
**I KËSHILLIT TË PAVARUR MBIKËQYRËS**  
**TË KOSOVËS**

**2009**

**PRISHTINË, MARS 2010**

## TABELA E PËRMBAJTJES

I.	<b>SHKURTESAT</b> .....	3
II.	<b>HYRJE</b> .....	4
III.	<b>PJESA E PËRGGJITHSHËME</b> .....	5
IV.	<b>ORGANIZIMI I BRENDSHËM I KPMK-SË</b> .....	6
V.	<b>FUNKSIONET E KPMK-SË</b> .....	6
VI.	<b>FUNKSIONI I ANKESAVE</b> .....	7
	a. Ankesat sipas objektit .....	7
	b. Struktura gjinore e ankuesve .....	7
	b. Struktura nacionale ankuesve.....	8
	d. Ankesat e ushtruara kundër vendimeve të autoriteteve punëdhënëse .....	8
	<b>VII. ANKESAT E PARAQITURA NË KPMK GJATË VITIT 2009</b> .....	9
	<b>VIII. ANKESAT E SHQYRTUARA GJATË VITIT 2009</b> .....	15
IX.	<b>ANKESAT E ZGJIDHURA GJATË VITIT 2009 DHE MËNYRA E ZGJIDHJES SË TYRE</b> .....	18
	1. Ankesat e zgjidhura .....	18
	2. Mënyra e zgjidhjes së ankesave.....	19
	3. Ankesat e aprovuara, pjesërisht të aprovuara dhe ex-officio dhe ekzekutimi i tyre.....	21
X	<b>ZBATIMI I VENDIMEVE TË KPMK-SË NGA ORGANET E PUNËSIMIT</b> .....	22
XI.	<b>FUNKSIONI I MBIKËQYRJES</b> .....	23
XII.	<b>FUNKSIONI I VËZHGIMIT</b> .....	26
XIII.	<b>BUXHETI</b> .....	29
XIV.	<b>BASHKËPUNIMI</b> .....	30
XV.	<b>PROBLEMET DHE VËSHTERËSITË</b> .....	31
XVI.	<b>SFIDAT E SË ARDHMES</b> .....	32
XVII.	<b>PERFUNDIMI</b> .....	33
	<b>SHTOJCA ME REKOMANDIMET E DËRGUARA INSITUCIONEVE</b> .....	

## I. SHKURTESAT

1. MAP - Ministria Administratës Publike
2. MAPL - Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal
3. MASHT- Ministria e Arsimit Shkencës dhe teknologjisë
4. MBPZHR - Ministria E Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
5. MD - Ministria e Drejtësisë
6. MEF - Ministria e Ekonomisë dhe Financave
7. MEM - Ministria e Energjisë dhe Minierave
8. MFSK - Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
9. MKK - Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit
10. MKRS - Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve
11. MMPH- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
12. MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
13. MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
14. MSH - Ministria e Shëndetësisë
15. MTPT - Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit
16. MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
17. APP - Agjencia e Prokurimit Publik
18. IAP - Institucioni i Avokatit të Popullit
19. AKK - Agjencia Kadastrale e Kosovës
20. QKUK - Qendra Kline Universitare e Kosovës
21. QKSPEZH - Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim
22. ASHAK - Agjencia Kadastrale e Kosovës
23. QS - Qendra e Studenteve
24. UP - Universiteti i Prishtinës
25. ESK - Enti i Statistikave të Kosovës
26. IAP - Instituti i Kosovës për Administratë Publike
27. ATK - Administrata Tatimore e Kosovës
28. IGJK - Instituti Gjyqësor i Kosovës
29. AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit
30. KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
31. ZAGJ - Zyra e Auditorit Gjeneral
32. EULEX - Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit
33. OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
34. UNDP - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
35. IOM - Organizata Ndërkombëtare për Migrim
36. KPMK - Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës
37. UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
38. SHCK - Shërbimi Civil i Kosovës
39. KE - Kryeshefi Ekzekutiv (agjencisë ekzekutive)
40. RREG - Rregullore për Shërbim Civil të Kosovës
41. UA - Urdhëresa Administrative (2003/2)
42. LPA - Ligji i Procedurës Administrative
43. UDHA - Udhëzimet Administrative (2008/01 dhe 2008/02)
44. AP - Autoriteti Punëdhënës
45. DFID - Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar

## II. HYRJJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës (KPMK), fillimisht është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, dhe ka filluar të funksionojë në vitin 2004 në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës (KPMK), është i paraparë në aktin më të lartë Juridik të Republikës së Kosovës, konkretisht me nenin 101.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, Këshilli është organ i pavarur që i raporton në mënyrë të drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës.

Mandati i KPMK-së është i përqendruar në shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civil dhe aplikuesve për punësim në shërbimin civil të Kosovës, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe parimeve mbi shërbimin civil si dhe vëzhgimin e zgjedhjes së drejtorëve të departamenteve dhe niveleve të njëjta.

Për të kryer funksionet e veta KPMK mbështet në këtë bazë ligjore:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 36/2001, për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 12/2008, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 36/2001 për Shërbimin Civil në Kosovë, Urdhëresa Administrativ nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr 2001/36, Udhëzimet administrative nr. MSHP/DASHC 2003/01-12, Ligjin mbi Procedurat Administrative nr. 02/L-028.

KPMK gjatë gjithë vitit 2009, fuqishëm ka qenë i angazhuar në përpjekje që të sigurohet një shërbim civil cilësor në frymën profesionale duke zbatuar legjislacioni për shërbimin civil që Kosova të ketë një administratë efikase me vlera dhe standarde evropiane.

Fondet e KPMK-së sigurohen nga buxheti i Kosovës.

### III. PJESA E PËRGJITHSHME

Në hierarkinë shtetërore, në frymën e kushtetutës dhe ligjshmërisë, vendi i nëpunësve civil është e mbetet, një nga komponentët më të rëndësishëm. Një shërbim civil i pavarur, i qëndrueshme dhe profesional është garanci e fuqishme e funksionimit të shtetit pavarësisht rrethanave dhe situatave të ndryshme.

Më qëllim, që Republika e Kosovës të ketë një shërbim civil efikas, të paanshëm e i bazuar në merita dhe që pasqyron karakterin multi-etnik të Kosovës, KPMK gjatë kryerjes së funksioneve të tij për periudhën raportuese, përmes shqyrtimit të ankesave të nëpunësve civil dhe aplikuesve për shërbim civil, mbikëqyrjen e respektimit të ligjit dhe parimeve udhëheqëse në shërbimin civil si dhe vëzhgimin e zgjedhjes së drejtorëve të departamenteve apo nivelit të njëjtë ka konstatuar se në shërbimin civil ka një progres, por ende nuk është arritur profesionalizmi i duhur, paanshmëria, përgjegjshmëria, respektimi i kodit etik si dhe zbatimi i procedurave dhe ligjit.

Nga shqyrtimi i ankesave të nëpunësve civil dhe aplikuesve konstatohet se nëpunësit civil nuk rekrutohen gjithëherë sipas procedurave të ndershme dhe meritës, avancimi nuk bëhet sipas meritës dhe procedurave, vlerësimet e performancës vjetore dhe për përtërihen apo mos përtëritje nuk bëhen gjithëherë objektive, kontratat e punës nuk lëshohen dhe përtërihen me kohëzgjatje në pajtim me ligjin dhe parimet. Disa nga zyrtarët e lartë përgjegjës për zbatimin e vendimeve të KPMK-së kanë treguar neglizhencë dhe papërgjegjësi në zbatimin e vendimeve ligjore të KPMK-së, gjë që në pajtim me Rregulloren nr. 12/2008, Këshilli, në mënyrë të rregullt ka njoftuar Kuvendin e Kosovës lidhur me mos zbatimin e vendimeve të Këshillit për secilin institucion veç e veç.

Nga mbikëqyrja e institucioneve për respektim të ligjit është konstatuar se ende jo të gjitha institucionet kanë dosjet e personelit në nivelin e standardeve, përshkrimet e punës të standardizuara, komisione disiplinore dhe të ankesave që zbatojnë parimet që shpesh bëhen instrumente me ndikim dhe nën presion në vendimmarrje, menaxherëve të personelit nuk iu është dhënë roli dhe përgjegjësia që duhet t'a kenë sipas ligjit. Institucionet të cilave u janë dërguar rekomandime kanë treguar neglizhencë dhe papërgjegjësi në zbatimin e tyre, por edhe njoftimin mbi zbatimin e tyre.

Nga vëzhgimet për zgjedhjen e drejtorëve të departamenteve dhe nivelit të njëjtë është një përmirësim i dukshëm me kontributin e veçantë të KPMK-së, duke mos lejuar përzgjedhjen përfundimtare pa u plotësuar kushtet ligjore për procedim, qoftë rreth konkursit, nivelit dhe përbërjes komisioneve duke konstatuar se me qenë se anëtar të komisioneve janë niveli i Sekretarëve Permanent, Kryeshefave ekzekutiv dhe drejtorëve të institucioneve të veçanta, është brengosëse se pothuajse të gjithë janë ushtrues detyre.

#### IV. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I KPMK-së

Organizimi i brendshëm i KPMK-së është i rregulluar me anë të Rregullores së brendshme mbi organizimin e KPMK-së, të cilat përcaktojnë në mënyrë të detajuar përgjegjësitë e anëtarëve të Këshillit si dhe çdo zyrtari në Sekretariatit e Këshillit.

**KËSHILLI** (KPMK-ja) përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Anëtarët e Këshillit zgjidhen përmes konkursit të hapur dhe transparent të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Kryetari i Këshillit zgjidhet nga vetë anëtarët e Këshillit. Mandati i të gjithë anëtarëve të Këshillit është 5 vjeçar.

**SEKRETARIATI** i KPMK-së, është organ që ndihmon Këshillin në realizimin e funksioneve dhe detyrave të tij dhe përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv, dy departamente. Aktualisht në Sekretariatit e KPMK-së janë të angazhuar 16 të punësuar në cilësinë e shërbyesve civil.

- Drejtori Ekzekutiv;
- Departamenti i Ankesave Monitorimit dhe Vëzhgimit (8 nëpunës);
- Departamenti i Administratës dhe Personelit (7 nëpunës);

Kapitujt në vijim paraqesin një tablo të plotë të mënyrës së ushtrimit të funksioneve nga ana e KPMK-së si dhe aktivitetet e kryera nga KPMK gjatë periudhës një vjeçare të raportimit, 1 Janar - 31 Dhjetor 2009.

#### V. FUNKSIONET E KPMK-SË

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, të ndryshuar me Rregulloren 2008/12, me të cilën rregullohet Shërbimi Civil i Kosovës, Këshilli ka kryer këto funksione:

1. Funksioni i shqyrtimit të ankesave, të parashtruara nga nëpunësit civilë dhe aplikuesit për punë në Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimeve të organit të punësimit.
2. Funksioni i Mbikëqyrjes mbi vlerësimin lidhur me respektimin të zbatimit të rregullave dhe parimeve të shërbimit civil të Kosovës
3. Funksioni i vëzhgimit të zgjedhjes së nëpunësve civilë në nivel të Udhëheqësve të Departamenteve dhe niveleve të njëjta, se a janë në përputhje me parimet udhëheqëse në shërbimin civil të Kosovës.

## VI. FUNKSIONI I ANKESAVE

Gjatë vitit 2009, në KPMK kanë arritur gjithsejtë 288 ankesa, te parashtruara nga nëpunësit civil dhe aplikuesit për punësim në Shërbim Civil të Kosovës.

Në mënyrë që të specifikohen më saktësisht llojet e ankesave KPMK në këtë raport ka ndarë ankuesit në tri kategori. Sipas objektit, strukturës nacionale dhe gjinore të ankesës, por duke i shtuar kështu edhe ankesat që janë bërë nga organet punëdhënëse.

### a) Ankesat sipas objektit :

Baza e ankimit të nëpunësve civilë që ankohen në KPMK, është e ndryshme. Gjatë vitit 2009 shumica dërmuese e ankesave, kanë pasur për objekt, kontestimin e konkurseve, ndërprerjen e kontratës së punës, mos vazhdimin e kontratës së punës, degradim nga pozita, suspendim nga puna etj. Nga kjo del se numri më i madh i ankesave ka të bëjë me: **Kontestimi Konkursi**, në 89 raste ose 30.90%, e të gjitha ankesave të arritura, në vitin 2009, pastaj pason si shkak i ankimit **Ndërprerja e Kontratës së Punës** me 65 raste ose 22.56%, të ankesave në përgjithësi, pastaj ajo për **Kompensim Material** me 47 raste ose 16.31%, pason shkak i **Degradimit nga Pozita** me 31 ankesa ose 10.76%, pastaj për shkak të shqiptimit të **Masave të Tjera Disiplinore** 31 ankesa ose 10.76%, për shkak të **Mos vazhimit të Kontratës**, 20 ankesa ose 6.94 %, të tjera 5 ankesa ( shif tabelën 3)





Fig 3 Tregon përqindjen e ankesave sipas objektit

### b) Struktura Gjinore:


Duke ju referuar numrit të përgjithshëm të ankuesve prej 288 në bazë të gjinisë dhe grupeve të cilët iu janë drejtuar KMPK-së, del se numri më i madh i ankuesve janë meshkuj dhe atë prej 220, ndërkaq femra 58. Ndërkaq 8 ankesa janë paraqitur nga grup ankuesish që nënkupton meshkuj dhe femra, dhe 3 ankesa nga autoritetet punëdhënëse. Edhe në këtë pjesë numri i përgjithshëm i ankuesve prej 288 ankesave, nëse ndahet në përqindje në formë grafikoni duket kështu:



**Fig 2. Tregon përqindjen e ankuesve sipas strukturës gjinore**

#### c) Struktura Nacionale:

Sipas strukturës nacionale del se shqiptarët i janë drejtuar KPMK-së, me numrin më të madh të ankesave dhe atë prej 276, ndërkaq serb janë 4, turq 2, boshnjak 3 dhe të tjerë 1. Numri i përgjithshëm i ankuesëve prej 288 ankuesëve, nëse ndahet në përqindje në formë grafikoni duket kështu:




**Tabela: Tregon përqindjen e ankuesve sipas strukturës nacionale**

#### d) Ankesat e ushtruara ndaj vendimeve të autoriteteve punëdhënëse

KPMK gjatë periudhës raportuese po ashtu ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave të ushtruara kundër vendimeve të autoriteteve punëdhënëse. Nga numri i ankesave që KPMK ka pranuar del se numri më i madh i ankesave të ushtruara është ndaj vendimeve të Komunave dhe atë me **163** ankesa, ose **56.59 %** e ankesave të përgjithshme, pasojë institucionet qendrore (Kryeministria dhe Ministrët) me **82**, ankesa ose **28.47 %**, pastaj vijnë Agjencitë e pavarura ekzekutive **33** ankesa, ose **15.45 %**. Këto të dhëna të paraqitura në mënyrë grafike duken si në vijim:





**Fig. 4 Tregon përqindjen e ankesave ndaj vendimeve të autoriteteve punëdhënëse**

## VII. ANKESAT E PARAQITURA NË KPMK GJATË VITIT 2009

### 1 Ankesave sipas objektit dhe institucionit

Gjatë procedimit të zgjedhjes së ankesave, nga komisionet e Këshillit, është konstatuar së janë disa autoritete punëdhënëse, kundër të cilave ankuesit ushtrojnë më shumë ankesa në KPMK, e nga disa tjera më pak.

Nga të dhënat e mëposhtme, shihet, se shumica e ankesave ku punojnë nëpunësit civilë, dhe aplikuesit për punësim në Shërbimin Civil të Kosovës, vijnë nga Komunat, Ministrinë, Agjencitë dhe institucionet tjera të pavarura.

#### 1. a) Ministrinë

Gjatë vitit 2009 ndaj Ministrive të Republikës së Kosovës janë ushtruar një numër i konsiderueshëm i ankesave. KPMK ka vërejtur se numri më i madh i ankesave me objekt ankimi në këtë grup të autoriteteve punëdhënëse -Ministrinë është ndërprerja e kontratave të punës, që pason me objektin e ankimit - kontestimi i konkurseve e kështu me radhë.

Tabela e mëposhtme pasqyron numrin e ankesave të arritura në KMPK gjatë vitit 2009 sipas institucionit dhe objektit të ankimit.

Autoritetet punëdhënëse MINISTRIT	Ndërprerja kontratës së punës	Mos vazhdim kontrate	Kontestim Konkursi	Kompensim material	Degradim nga Pozita	Suspendim nga Puna	Të tjera	Gjithsej
MAP			1				1	2
MD	8		1		1			10
MASHT	3		3	1	1	1	1	10
MSH							2	2
MPMS	4	2	2	4				12
MMPH			3					3
MEM			1					1

MPB	2			3	7			12
MKK	2	4						6
MTI					1		1	2
MKRS	1	1	2					4
MBPZHR	2		5			2	2	11
MTPT	2							2
Adm. e Presidencës	0	0	0	0	0	0	0	0
ZKM			3				1	4
MEF	0	0	0	0	0	0	0	0
MFSK	0	0	0	0	0	0	0	0
MAPL	0	0	0	0	0	0	0	0
MPJ	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>24</b>	<b>7</b>	<b>21</b>	<b>8</b>	<b>10</b>	<b>3</b>	<b>8</b>	<b>81</b>

Tabela I: Ankesat e arritura në KPMK, kundër ministrive për vitin 2009

Siç po shihet në tabelën e më sipërme numri i tërësishëm i ankesave sipas institucionit dhe objektit të ankimit ndaj Ministrive është 81 të pranuar gjatë vitit 2009. Ky numër i ankesave ndaj ministrive në përqindje është: Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale me 12 ankesa ose 16%, Ministria e Punëve të Brendshme me 12 ankesa ose 16%, Ministria e Bujqësisë me 11 ankesa ose 14%, Ministria e Drejtësisë me 10 ankesa ose 12%, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me 10 ankesa ose 12%, Ministria për Kthim dhe Komunitete me 6 ankesa ose 7%, Zyra e Kryeministrit me 4 ankesa ose 5%, Ministria e Kulturës Rinis dhe Sporteve me 4 ankesa ose 5%, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me 3 ankesa ose 4%, Ministria e Shëndetësisë me 2 ankesa ose 2%, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me 2 ankesa ose 2%, Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit me 2 ankesa ose 2%, Ministria e Administratës Publike me 2 ankesa 2%, Ministria e Energjisë dhe Minierave 1 ankesë ose 1%: **Figura e më poshtme tregon pasqyrën e përqindjes së ankesave ndaj Ministrive.**



Fig. 5. Tregon përqindjen e ankesave ndaj Ministrive

## 1. b) Komunat

Gjatë vitit 2009 edhe ndaj komunave janë ushtruar një numër i konsiderueshëm i ankesave. Për dallim nga grupi i autoriteteve punëdhënëse Ministrisë ku numri më i madh i ankesave me objekt ankimi - ndërprerja e kontratës së punës, KPMK ka vërejtur se në këtë grup të autoriteteve punëdhënëse - komunave numri më i madh i ankesave me objekt ankimi është kontestimi i konkurseve që pason me objekt ankimi - shkëputjen e kontratave të punës.


Tabela e mëposhtme pasqyron numrin e ankesave të arritura në KMPK gjatë vitit 2009 sipas institucionit dhe objektit të ankimit.

Autoritet punëdhënëse KOMUNAT	Ndërprerja kontratës së punës	Mos vazhdim kontrate	Kontestim Konkursi	Kompensim material	Degradim nga Pozita	Suspendim nga Puna	Të tjera	Gjithsej
Prishtinë	3	3	4	7	1		1	19
Gjilan		1	10		4		5	20
Prizren		1	4		2			7
Skenderaj	1		1	2			1	5
Ferizaj	2		15		1		1	19
Lipjan	1	1	1				1	4
Malishevë			1	2				3
Kamenicë	1	1	1	1	2		1	7
Vushtrri	2		2	2				6
Suharekë	3	1	3	1	1			9
Kaçanik	1		2					3
Klinë	2						1	3
Pejë	1		3		1		1	6
Viti	6	4	1					11
Glllogoc	1		1	2				4
Obiliq							2	2
Istog				1			1	2
Gjakovë			3	2			1	6
Mitrovicë	6		3	3				12
Podujevë				1				1
Shtime	2			1				3
Deçan				2				2
Hani i Elezit	1							1
Rahovec				2				2
Shtërpcë		1	4					5
Junik	1							1
F. Kosovë								0
Dragash								0
Novo Bërdë								0
Graçanicë								0
Leposaviç								0
Mamushë								0
Partesh								0

Zubin Potok								0
Zveçan								0
<b>Gjithsej</b>	<b>34</b>	<b>13</b>	<b>59</b>	<b>29</b>	<b>12</b>		<b>16</b>	<b>163</b>

**Tabela II: Ankesat e arritura në KPMK, kundër komunave**

Sa i përket komunave, nga numri i tërësishëm ankesave prej 163 të pranuar gjatë vitit 2009 ndaj vendimeve të Komunave si autoritete punëdhënëse, është bërë ndarja e tyre në përqindje. Figura e më poshtme tregon këtë përqindje: Komuna e Gjilanit me 20 ankesa ose 12%, Prishtina me 19 ankesa ose 12%, Ferizaj me 19 ankesa, ose 12%, Mitrovica me 12 ankesa ,ose 7%, Vitia me 11 ankesa ose 7%, Suhareka me 9 ankesa ose 6%, Prizreni me 7 ankesa ose 4%, Kamenica me 7 ankesa ose 4%, Vushtrria me 6 ankesa ose 4%, Peja me 6 ankesa ose 4%, Gjakova me 6 ankesa ose 4%, Skenderaj me 5 ankesa ose 3%, Shtërpca 5. ankesa ose 3%, Drenas me 4 ankesa ose 2%, Lipjani me 4 ankesa, ose 2%, Malisheva me 3 ankesa ose ,2%, Kaçaniku me 3 ankesa ose 2%, Klina me 3 ankesa ose 2%, Shtime me 3 ankesa ose 2%, Deçani me 2 ankesa ose 1%, Istogu me 2. ankesa ose 1%, Obiliqi me 2 ankesa ose 1%, Rahoveci me 2. ankesa ose 1%, Hani i Elezit me 1 ankesa ose 1%, Podujeva me 1 ankesë ose 1%, Juniku me 1 ankesë ose 1%.



**Fig. 6. Tregon përqindjen e ankesave ndaj Komunave**

### 1.c) Agjencitë dhe institucionet tjera të pavarura

Edhe ndaj Agjencive dhe institucioneve tjera të pavarura si autoritete punëdhënëse gjatë vitit raportues 2009 KPMK ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave.

Për dallim nga dy grupet e autoriteteve punëdhënëse të më sipërme ku në të parën dominonte objekti i ankimit - ndërprerja e kontratës së punës, ndërsa në të dytën kontestimi i konkurseve në këtë grup të autoriteteve punëdhënëse Agjencitë dhe institucionet e tjera të pavarura dominon objekti i ankimit - degradimi nga pozita që pason me kontestimin e konkurseve. Tabela e mëposhtme pasqyron numrin e ankesave të arritura në KMPK gjatë vitit 2009 sipas institucionit dhe objektit të ankimit.

Autoritete punëdhënëse	Ndërprerje kontratës së punës	Mos vazhdim kontrate	Kontestim Konkursi	Kompensim material	Degradim nga Pozita	Suspendim nga Puna	Të tjera	Gjithsej
<b>AGJENCIT e PAVARURA</b>								
QKUK			1		3	1	1	6
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1							1
Agjencia për Produkte dhe Pajisje Medicinale					1			1
Spitali i Vushtrrisë				1				1
Spitali i Gjilanit					2			2
Spitali i Prizrenit	1				1		2	4
Agjencia Tatimore e Kosovës	1						2	3
Universiteti i Prishtinës	2		1				1	4
Avokati i Popullit			2					2
Qendra e Mjekësisë Familjare Skenderaj				1				1
Qendra e Mjekësisë Familjare Ferizaj					1			1
Qendra e Mjekësisë Familjare Gjilan					1			1
Qendra e Mjekësisë Familjare Prishtinë				1				1
Spitali i Gjakovës	1							1
Ins. Komb. i Shëndetit Publik			2	4				6
Dogانات e Kosovës	1							1
Komisioni për Ndihmë Juridike							1	1
Gjykata Komunale Gjilan			1					1
TMK				2				2
APK Prizren						1		1
Komisioni I pavarur për Miniera dhe Minerale			1					1
Gjykata Supreme				1				1
KQZ								
<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>		<b>8</b>	<b>1</b>	<b>9</b>	<b>2</b>	<b>7</b>	<b>44</b>

**Tabela III: Ankesat e arritura ne KPMK, kundër agjencive dhe institucioneve të pavarura**

Siç po shihet nga tabela III totali i ankesave të arritura në KPMK gjatë vitit 2009 është 44. Ky total është ndarë në përqindje dhe ka dhënë një pasqyrë: Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik me 6 ankesa ose 14%, QKUK me 6 ankesa ose 14%, Spitali Regjional i Prizrenit me 4 ankesa ose 9%, Universiteti i Prishtinës me 4 ankesa ose 9%, Administrata Tatimore e Kosovës me 3 ankesa ose 7%, Avokati i Popullit me 2 ankesa ose 5%, Spitali Regjional i Gjilanit me 2 ankesa ose 5%, TMK me 2 ankesa ose 5%, Këshilli Gjyqësor i Kosovës me 1 ankesë ose 2%, Agjencia për Produkte dhe Pajisje Medicinale me 1 ankesë ose 2%, Spitali "Sheik Zaid" Vushtrri me 1 ankesë ose 2%, QKMF – Skenderaj me 1 ankesë ose 2%, QKMF – Ferizaj me 1 ankesë ose 2%, QKMF – Gjilan me 1 ankesë ose 2%, QKMF me 1 ankesë ose 2%, Spitali Rajonal i Gjakovës me 1 ankesë ose 2%, Doganat e Kosovës me 1 ankesë ose 2%, Komisioni për Ndihmë Juridike me 1 ankesë ose 2%, Gjykata Komunale e Gjilanit me 1 ankesë ose 2%, APK Prizren me 1 ankesë ose 2%, Komisioni për Miniera dhe Minerare me 1 ankesë ose 2%, Gjykata Supreme me 1 ankesë ose 2%

Figura e më poshtme tregon ndarjen në përqindje të ankesave ndaj agjencive dhe institucioneve tjera të pavarura.




Fig. 7. Tregon përqindjen e ankesave ndaj Agjencive dhe institucioneve tjera të pavarura

## VIII. ANKESAT E SHQYRTUARA TË VITIT 2009

Ankesat e pranuar gjatë vitit 2009 janë 288, prej të cilave Këshilli ka vendosur 167, ndërsa pjesa tjetër e ankesave ka arritur në tre mujorin e fundit të vitit 2009 që ka mbetur të vendosen gjatë vitit 2010 gjithnjë brenda afatit ligjor.

Komisionet e KPMK-së që kanë përbërje prej tre anëtarësh, në pajtim me bazën ligjore kanë vendosur ankesat përmes këshillim - votimit dhe seancave dëgjimore.

**Këshillim - votimi** nënkupton vendosjen e një ankesë në bazë të fakteve, provave të paraqitura në lëndë, nga ana e ankuesit dhe përgjigjes në ankesë, nga autoriteti punëdhënës, të cilës ia bashkon provat me të cilat disponon.

**Seanca dëgjimore** nënkupton thirrjen e palëve në seancë dëgjimore, në të cilën palëve, pos fakteve të paraqitura në formë të shkruar, u jepet rast, të deklarohen dhe ballafaqohen drejtpërdrejt, para komisionit të këshillit dhe mundësisë së akt pajtimit.

Nga të dhënat e mëposhtme, shihet, se KPMK ka pasur të bëjë me vendosjen e ankesave të pranuar ndaj Ministrive, Komunave, Agjencive dhe institucioneve tjera të pavarura.

### 2. a) Ministrinë

Në këtë grup të autoriteteve punëdhënëse gjatë vitit raportues 2009 KPMK ka pranuar 81 ankesa, ndërkaq komisionet e KPMK-së i kanë shqyrtuar dhe vendosur 50 ankesa, ndërsa për shkak të bartjes së ankesave edhe nga vitet paraprake 31 ankesa të vitit 2009 janë bartur për tu vendosur në vitin 2010 brenda afatit ligjor. Duke u bazuar në mënyrat e shqyrtimit dhe të vendosjes së ankesave të cekura më lartë komisionet e KPMK-së, ankesat e paraqitura ndaj autoriteteve punëdhënëse Ministrinë i ka vendosur kështu: shih tabelën në vijim:

Ankesat e shqyrtuara	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Të Palejuara	Përfundim procedimi	Ex Officio	Nr i ankesave të shqyrtuara	Të ekzekutuara	Të pa ekzekutuara
MINISTRIT										
MAP	1	1						2		1
MD	1	2						3	1	
MASHT	1	1	1					3	1	
MSH	1							1		1
MPMS	5	1		3				9	3	2
MMPH	1								1	
MEM		1						1		
MPB	1	6					1	8		1
MKK	3	1						4	1	2
MTI		1	1					2		1

MKRS	1		2	1				4	1	2
MBPZHR	2	2					2	6	1	3
MTPT		1						1		
ZKM	2						2	4	1	2
Kuvendi		1						1		
MEF										
MFS										
MPL										
MPJ										
<b>Gjithsej</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>4</b>	<b>4</b>			<b>5</b>	<b>50</b>	<b>10</b>	<b>15</b>

Tabela IV: Ankesat e shqyrtuara të vitit 2009 ndaj ministrive

## 2. b) Komunat

Në këtë grup të autoriteteve punëdhënëse gjatë vitit raportues 2009 KPMK ka pranuar 163 ankesa, ndërkaq komisionet e KMPK-së i kanë shqyrtuar dhe vendosur 84 ankesa, ndërsa për shkak të bartjes së ankesave edhe nga vitet paraprake 79 ankesa të vitit 2009 janë bartur për tu vendosur në vitin 2010 brenda afatit ligjor. Komisionet e KPMK-së, ankesat e paraqitura ndaj autoriteteve punëdhënëse Komunave i ka vendosur kështu: shih tabelën në vijim:

Ankesat e shqyrtuara KOMUNAT	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Të Palejuara	Përfundim procedimi	Të pezulluara	Ex Officio	Nr i ankesave të shqyrtuara	Të ekzekutuara	Të pa ekzekutuara
Prishtinë	2	1				1	1		5		2
Gjilan	6	4	3	2				1	16	2	7
Prizren	2		2						4	1	3
Skenderaj				1					1		
Ferizaj		6	1	1				1	9	1	1
Lipjan											
Malishevë							1		1		
Kamenicë	2	1	1						4		3
Vushtrri	2								2	1	1
Suharekë	1	5		1					7		1
Kaçanik	2		1						3		3
Klinë		1		2					3		
Pejë		1							1		
Viti	7	1							8	1	6
Glogoc	1	1							2		1
Obiliq	1								1	1	
Istog	1								1		1
Gjakovë	1	1		1					3		1
Mitrovicë	3		2						5		5



Podujevë	1								1		1
Shtime	3								3		3
Deçan	1								1		1
Hani i Elezit	1								1		1
Rahovec	1								1		1
Shtërpçë		1							1		1
Junik											
F. Kosovë											
Dragash											
Novo Bërd											
Graçanicë											
Leposaviq											
Mamushë											
Partesh											
Zubin Potok											
Zveçan											
<b>Gjithsej</b>	<b>38</b>	<b>23</b>	<b>10</b>	<b>8</b>		<b>1</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>Totali: 84</b>	<b>7</b>	<b>32</b>

Tabela v: Ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2009 ndaj komunave

## 2. c) Agjencitë dhe institucionet tjera të pavarura

Në këtë grup të autoriteteve punëdhënëse gjatë vitit raportues 2009 KPMK ka pranuar 44 ankesa, ndërkaq komisionet e KMPK-së i kanë shqyrtuar dhe vendosur 32 ankesa. Për shkak të bartjes së ankesave edhe nga vitet paraprake 12 ankesa të vitit 2009 janë bartur për tu vendosur në vitin 2010 brenda afatit ligjor. Komisionet e KMPK-së, ankesat e paraqitura ndaj autoriteteve punëdhënëse Agjencitë dhe institucionet tjera të pavarura i ka vendosur kështu: shih tabelën në vijim:

Ankesat e shqyrtuara AGJENCIT e PAVARURA	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Të Palejuara	Përfundim procedimi	Ex Officio	Të pezulluara	Nr i ankesave të shqyrtuara	Të ekzekutuara	Të pa ekzekutuara
	QKUK	2	2				1		1	6	1
KGJK	1								1		1
AKPM			1						1		1
Spitali Vushtrri				1					1		
Spitali Gjilan	1								1		1
Spitali Prizren	1	2							3	1	

ATK		1					2	3		
UP				4				4		
Avokati i Popullit										
QKMF-Skenderaj	1							1		1
QKMF-Ferizaj		1						1		
QKMF-Gjilan										
QKMF-Prishtinë										
Spitali Gjakovë		1						1		
IKSHPK	6							6		6
Doganat e Kosovës										
KNJ			1					1		1
Gjykata Komunale Gjilan				1				1		
TMK										
APK-Prizren										
KPMM	1							1		1
Gjykata Supreme										
KQZ										
Instituti i Historisë										
Arkivi i Kosovës										
Administrata e Policisë										
ASK										
Qendra Fiskale										
Gjithsej	13	7	2	6		1	3	Totali: 32	2	13

Tabela VI: Ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2009 kundër agjencive dhe institucioneve të pavarura

## IX. ANKESAT E ZGJIDHURA GJATË VITIT 2009 DHE MËNYRA E ZGJEDHJES SE TYRE.

### 1. Ankesat e zgjidhura

KPMK gjatë vitit 2009, përmes komisioneve ka **zgjidhur gjithsejtë 358 ankesa**. Ky numër i tërësishëm i zgjidhjes së ankesave ka të bëjë edhe me ankesat e shqyrtuara në mënyrë retroaktive nga vitet paraprake. Kjo ka ndodhur pasi që në vitet paraprake Këshilli nuk ka pasur kapacitet të zgjidh ato si rrjedhojë e mos kompletimit të tij. Në përgjithësi, shihet, se gjatë vitit 2009, janë zgjidhur 358 ankesa, prej tyre, ankesa të vitit 2009 janë vendosur 180, ndërsa të viteve paraprake, janë zgjedhur 178 sish. Në krahasim me vitin paraprak edhe në vitin 2009, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, kanë arritur **99 ankesa me pak** krahasuar me vitin paraprak.

Retroaktiviteti i zgjidhjes së ankesave të viteve paraprake është si në vijim. Gjatë vitit 2009 janë zgjedhur 169 ankesa të bartura nga vitit 2008, 7 ankesa janë zgjedhur të vitit 2007 dhe 2 ankesa janë zgjidhur nga viti 2005. Forma e zgjidhjes së ankesave gjatë vitit 2009 dhe ankesat e mbetura nga vitet 2008, 2007 dhe 2005 është thjeshtëzuar edhe në formën tabelare në vijim:

Ankesat sipas viteve	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Të palejuara	Përfundim procedimi	Ex Officio	Të pezulluara	Totali	Të ekzekutuara	Të pa ekzekutuara
2009	68	56	17	16		10	7	5	180	16	15
2008	46	62	28	13	6	10	1	3	169	7	32
2007	1	2	1	2				1	7	2	13
2005		2							2		
<b>Gjithsej</b>	<b>115</b>	<b>122</b>	<b>46</b>	<b>31</b>	<b>6</b>	<b>20</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>358</b>	<b>25</b>	<b>60</b>

Tabela përmbledhëse mbi ankesat e zgjedhura në bazë të viteve

### 2. Mënyra e zgjidhjes së ankesave

Mënyra e zgjidhjes së ankesave reflekton ndarjen e tyre në të: aprovuara, pjesërisht të aprovuara, të refuzuara, të hedhura poshtë, përfundim procedure, ex-officio dhe të pezulluara.

#### Të aprovuara

Janë ankesat e paraqitura nga nëpunësit civil apo aplikuesit, dhe që në bazë të provave argumenteve dhe fakteve është anuluar vendimi i organit punëdhënës, dhe njëherit është obliguar për ekzekutimin e vendimeve të KPMK-së. Numri i ankesave të aprovuara gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ankesat e arritura gjatë viteve paraprake është 115.

#### Pjesërisht të aprovuara

Janë ankesat të cilat kanë dy e më shumë pretendime ankimore dhe kur ankesa nuk aprovohet në tersi. Kjo ndodhë në rastet kur organi punëdhënës obligohet që të përmbushë

ndonjërin nga obligimet procedurale si psh: rishpallje konkursi. Numri i ankesave të pjesërisht të aprovuara gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ato të arritura gjatë viteve paraprake është 46.

#### Të refuzuara

Janë ankesat e paraqitura nga nëpunësit civil të cilat në bazë të provave argumenteve dhe fakteve të paraqitura nga organi punëdhënës refuzohen si të pa bazuara. Numri i ankesave të refuzuara gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ato të arritura gjatë viteve paraprake është 122.

#### Të hedhura poshtë

Janë ankesat të cilat pranohen dhe shqyrtohen nga ana e komisioneve të KMPK-së por që hedhen poshtë si rezultat i jo kompetencës së KMPK-së, pastaj në rastet kur kemi të bëjmë me ankesa të paraqitura jashtë afatit ligjor, mos plotësimin e ankesës në afatin ligjor nga ankuesi. Numri i ankesave të hedhura poshtë gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ato të arritura gjatë viteve paraprake është 31.

#### Të pa lejuara

Janë ankesat të cilat shqyrtohen nga komisionet e KMPK-së dhe konstatohet se nuk kanë të drejtën e ankimit në KPMK. Këto raste kanë të bëjnë me ankesat e organeve të punësimit që paraqesin ankesë kundër vendimeve të ankesave të vet organit punëdhënës ose kur ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil apo aplikuesit për nëpunës civil. Numri i ankesave të palejuara gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ato të arritura gjatë viteve paraprake është 6.

#### Ex-officio

Janë ankesat e nëpunësve civil dhe aplikuesve të cilat shqyrtohen nga komisionet e KMPK-së, por që pas shqyrtimit konstatohet se ka shkelje procedurale të cilat me vendimin e KMPK-së, obligohet organi punëdhënës që të ndërmarr veprime procedurale, që pastaj për të vendosur ankesën, sipas objektit të ankimit nga KPMK-ja. Numri i ankesave të ex-officio gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ato të arritura gjatë viteve paraprake është 8.

#### Përfundim Procedimi

Janë ankesat e nëpunësve civil dhe aplikuesve për të cilat përfundon procedimi administrativ për shkak të tërheqjes së ankesës, eliminimit të arsyes për ankimit, ose për shkak të braktisjes së ankesës nga ana e ankuesit kur ankuesi nuk ka qenë i interesuar dhe jo aktiv mbi tre muaj dhe kur konstatohet se objekti për të cilin është filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pa mundur. Numri i ankesave me përfundim procedimi gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ato të arritura gjatë viteve paraprake është 20.

#### Të pezulluara

Janë ankesat e nëpunësve civil që për marrjen e vendimit përfundimtar në procedurë administrative duhet të pritet në vendim paraprak të një organi kompetentë apo vendimin e gjykatës. Numri i ankesave të pezulluara gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ato të arritura gjatë viteve paraprake është 9.

Nga numri i tërësishëm i ankesave të zgjidhura në vitin 2009 nga ana e Komisioneve të KPMK-së, rezulton se janë: të aprovuara 115 ankesa ose 31%, pjesërisht të aprovuara 46 ankesa ose 13%, të refuzuara 122 ankesa ose 33%, të hedhura poshtë 31 ankesa ose 9%, me përfundim procedure 20 ankesa ose 6%, ex officio 9 ankesa ose 2.% dhe janë pezulluar 9 ankesa ose 3%.




Fig. 8 Tregon ndarjen në përqindje të ankesave sipas viteve të zgjidhura në 2009

### 3. Ankesat e aprovuara, pjesërisht të aprovuara, ex-officio dhe ekzekutimi i tyre

Ankesa të aprovuara, pjesërisht të aprovuara dhe ex officio në vitin 2009, të cilat nuk janë ekzekutuara nga ana e autoriteteve punëdhënëse janë si në vijim : Aprovuar 115 ankesa prej tyre, sipas njoftimeve që ka marrë nga palët procedurale janë zbatuar 25 vendime të KPMK-së nga kjo kategori e vendimeve nuk janë ekzekutuar 55 vendime, ndërsa për 35 vendime KPMK nuk ka të dhëna se janë ekzekutuar apo jo edhe përkundër obligimit ligjor që kanë Autoritetet punëdhënëse për të njoftuar KPMK-në.

Gjithashtu Komisionet e KPMK-së gjatë vitit 2009 kanë Aprovuar Pjesërisht 46 ankesa dhe 8 ex officio prej tyre janë ekzekutuar 14 vendime të KPMK-së, ndërsa nuk janë ekzekutuar 21 vendime, për 11 vendime KPMK-ja, nuk ka të dhëna se janë ekzekutuar apo jo nga ana e Autoriteteve punëdhënëse.




Fig. 9 Tregon përqindjen ankesave të aprovuara, pjesërisht të aprovuara dhe ex - officio si dhe ekzekutimin apo mos ekzekutimin e vendimeve të KMPK-së.

#### X. ZBATIMI I VENDIMEVE TË KPMK-SË NGA ORGANET PUNËDHËNËSE

Vendimet e KPMK-së, janë të obligueshme që të zbatohen nga organet punëdhënëse në Shërbimin Civil të Kosovës, meqë në bazë të nenit 11 paragrafi 11.6, të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 12/2008, ato janë vendime administrative të formës së prerë dhe ndaj tyre nuk lejohet ankesa, por që ju nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin. Mosekzekutimi i tyre nga personat përgjegjës, konsiderohet cenim i të drejtave nga marrëdhënia e punës të nëpunësit të SHC, apo aplikuesit për në ShCK. Sipas nenit 11 paragrafi 11.3 të Rregullores nr. 2008/12, përgjegjës për zbatimin e vendimeve të KPMK-së janë sekretarët e përhershëm të Ministrive kryeshefat ekzekutivë të Agjencive dhe institucioneve te pavarura, kryetarët e komunave dhe përgjegjësit kryesor te organit përkatës të punësimit.

Përkundër këtij fakti që vendimet e KPMK-së janë të formës së prerë në procedurë administrative siç shihet në tableta e më sipërme prej 169 ankesave të aprovuara, pjesërisht të aprovuara dhe ex officio autoritetet punëdhënëse nuk i kanë zbatuar 76 vendime që për KPMK-në paraqet një shqetësim të madh. Në këtë drejtim shqetësim paraqet edhe fakti që autoritetet punëdhënëse nuk kanë njoftuar KPMK-në për zbatimin apo jo të 46 vendimeve.

Në pajtim me nenin 11. paragrafi 11.4 të Rregullores nr. 12/2008, KPMK-ja pas njoftimit nga ankuesi për mos zbatimin e vendimit në afatin e përcaktuar ligjor, në mënyrë të rregullt ka njoftuar Kuvendin e Kosovës lidhur me mos zbatimin e vendimeve të Këshillit për secilin institucion veç e veç.

Sipas të dhënave të Sekretariatit të KPMK-së, për njoftimet që kanë paraqitur ankuesit për mos ekzekutimin e vendimeve të KPMK-së, përmenden këto autoritete punëdhënëse:

Vendimet e pa ekzekutuara sipas institucionit janë si në vijim:

Ministritë	Nr. i vendimeve të pa ekzekutuara	Komunat	Nr. i vendimeve të pa ekzekutuara	Agjencitë dhe institucionet tjera të pavarura	Nr. i vendimeve të pa ekzekutuara
ZKM	1	Viti	6	IKSHP	5
MSH	1	Mitrovicë	6	Spitali-Gjilan	1
MPBZHR	2	Gjilan	12	QKMF-	1

				Skenderaj	
MASHT	5	Shtime	3		
MPMS	1	Kaçanik	3		
MKRS	2	Gjakovë	1		
MKK	3	Vushtrri	2		
		Pejë	1		
		Deçan	1		
		Kamenicë	3		
		Prizren	3		
		Istog	3		
		Obiliq	1		
		Klinë	1		
		Skenderaj	2		
		Podujevë	1		
		Malishevë	2		
		Prishtinë	3		
		Lipjan	2		
		Suharekë	1		

## XI. FUNKSIONI I MBIKËQYRJES

### Vlerësimi i respektimit të ligjit

Funksionin e mbikëqyrjes KPMK e ushtron mbi bazën e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës të ndryshuar me Rregulloren nr. 2008/12 neni 12 mbi monitorimin e respektimit të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës, Urdhëresës Administrative 2003/2 dhe Udhëzimeve Administrative nr. MSHP/DASHC 2003/01-12.

Për të siguruar nëse autoritetet punëdhënëse e zbatojnë apo jo bazën ligjore të lartë përmendur hapi i parë që bënë Këshilli është që të sigurojë të dhënat e përgjithshme nga institucioni i caktuar mbi: - Statusin e shërbimit të personelit dhe menaxherit (në rastet e institucioneve qendrore) apo udhëheqësit të personelit nëpër komuna; - Numrin e nëpunësve civil; - Strukturën nacionale dhe gjinore etj.

Këshilli në vitin 2009 ka realizuar 80 vizita në institucione qendrore dhe lokale ( me përjashtim të pesë komunave Gracanicë, Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Partesh edhe përkundër përpjekjeve që ka bërë Këshilli për të realizuar vizitë edhe në këto komuna).

Gjatë punës praktike të vitit raportues KPMK ka konstatuar disa shkelje të zbatimit të ligjit mbi shërbimin civil, procedurave dhe parimeve udhëheqëse mbi Shërbimin Civil të Kosovës.

## **Menaxhimi i personelit**

Shumica e institucioneve si qendrore ashtu edhe ato lokale nuk kanë zbatuar plotësisht obligimin ligjor që menaxheri apo udhëheqësi i personelit të ketë rolin, përgjegjësitë dhe autorizimet që i takojnë me ligj dhe në disa raste nuk kanë fare menaxher të personelit.

### **Procedurat e rekrutimit dhe selektimit:**

Gjatë vizitave që komisionet e KMPK-së kanë zhvilluar nëpër institucione të ndryshme kanë konstatuar se në disa institucione autorizimi i rekrutimit të nëpunësve civil nuk iniciohet dhe aprovohet në pajtim me procedurat, publikimi i konkurseve nuk bëhet gjithë herë në bazë të parimit të gjithë përfshirjes, komisionet e rekrutimit nuk janë në përbërje të nivelit për postin e publikuar, rekrutohen kandidat në kundërshtim me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të konkursit dhe parimit të meritës, me rastin e rishpallje së konkurseve shpesh ndryshohen kushtet e konkursit që do të thotë se i përshtatën kandidatëve të caktuar që paraqet shkelje të parimeve udhëheqëse të shërbimit civil.

### **Procedura e kontratave:**

Gjatë monitorimit komisionet e KMPK-së kanë konstatuar se kontrata e punës lëshohen me kohë zgjatje në kundërshtim me procedurat dhe ligjin, lëshohen kontrata për shërbyes civil e të cilët nuk janë zgjedhur sipas konkursit publik me bazë konkurruese dhe procedura të ndershme, në disa raste janë konstatuar edhe lëshime të kontratave mbi vepër që është shkelje e ligjit, pasi që në shërbimin civil njihen vetëm kontratat e punës që lëshohen pas zbatimit të procedurave të rregullta përmes konkursit publik. KMPK gjatë monitorimit ka vërejtur se në disa institucione kontratat e punës nuk janë përtërirë sipas afatit dhe procedurave ligjore.

### **Procedura e ankesave**

Gjatë monitorimit komisionet e KMPK-së kanë vërejtur se disa institucione nuk kanë themeluar institucionin e ankesave dhe disa edhe nëse kanë themeluar përbërja e tyre nuk është në pajtim me procedurat. Ankesat shpesh nuk shqyrtohen fare brenda afatit ligjor dhe pas heshtjes administrative nëpunësit civil apo aplikuesit i drejtohen me ankesë KMPK-së. Këshilli shpesh obligon ex-officio autoritetet punëdhënëse që të shqyrtojnë ankesën e nëpunësit apo aplikuesit, kështu që kjo shkakton vonesën për shqyrtim të ankesës nga ana e komisioneve të KMPK-së për të nxjerr vendim merititor.

### **Procedura disiplinore**

Gjatë monitorimit Komisionet e KMPK-së kanë vërejtur se disa institucione nuk kanë themeluar komisionin disiplinor në pajtim me bazën ligjore në fuqi. Lidhur me përgjegjësinë disiplinore shpesh merren vendime arbitrare pa u proceduar përmes menaxherit të personelit dhe komisionit disiplinor. Në disa institucione nëpunësit civil nuk janë të njoftuar me Kodin e mirësjelljes për nëpunësit civil, që nënkupton edhe mungesën e informacioneve mbi konfliktin e interesit.

### **Procedura e periudhës provuese**

KMPK gjatë monitorimit ka vërejtur në disa institucione, plani i periudhës provuese sikurse edhe vlerësimi i përfundimit të periudhës provuese nuk bëhet në pajtim me procedurat dhe ligjin.



**Procedura e ndërprerjes së marrëdhënies së punës**

Gjatë monitorimit KPMK ka vërejtur se ndërprerja e marrëdhënies së punës në disa institucione është bërë në kundërshtim me procedurat dhe bazën ligjore. Duke u mbështetur në bazën ligjore në fuqi, ndërprerja e marrëdhënies së punës së nëpunësve civil bëhet vetëm me vendim të komisioneve disiplinore apo bazës së dorëheqjes me vullnetin e tij, pensionimin, vdekjes dhe skadimit të kontratës, por me kusht që vendi i punës shuhet dhe nuk pranohen punonjës të ri për vendin e caktuar të punës.

**Procedura e përshkrimeve të punës**

KMPK ka vërejtur se shumica e institucioneve ende nuk kanë standardizuar përshkrimet e punës, gjegjësisht rregulloret mbi sistematizimit e vendeve të punës, duke kaluar procedimin e rishikimit të tyre dhe aprovimit përfundimisht nga menaxherët e personelit.

**Procedura e vlerësimit të kryerjes së punëve**

Edhe në këtë funksion, KPMK ka vërejtur se jo të gjitha institucionet bëjnë vlerësimin e kryerjes së punëve për vitin kalendarik. KPMK po ashtu ka vërejtur se ky vlerësim në disa raste është bërë në mënyrë fiktive, ndërsa gjatë vizitave në shumë raste kemi inkurajuar se vlerësimi duhet të bëhet në mënyrë objektive duke respektuar parimet e shërbimit civil. Disa institucione me rastin e përpirjes së kontratave marrin për bazë vlerësimin e kryerjes së punës e jo vlerësimin e performancës sipas procedurës së kontratave.

**Procedura mbi pushimet**

KMPK ka vërejtur se procedura e të gjitha llojeve të pushimeve menaxhohet sipas procedurave, por është vërejtur se disa institucione kanë problem me lejimin e pushimeve mjekësore të stërzgjatura në shumicën e rasteve KMPK ka vërejtur s kjo ndodhë si rezultat i sëmundjeve të rënda.

**Procedura mbi orarin e punës dhe vijueshmërinë**

Gatë kësaj periudhë raportuese KMPK ka vërejtur se pothuajse në të gjitha institucionet menaxhohet vijueshmëria në punë dhe respektimi i orarit të punës.

**Procedura mbi mundësit e barabarta**

KMPK ka vërejtur se disa institucione ende nuk kanë arritur të sigurojnë njësit për të drejtat e njeriut dhe mundësit e barabarta, siç dihet zyra për mundësi të barabarta duhet të inkurajojë punësimin e minoriteteve, të sigurojë barazinë gjinore, si dhe inkurajimin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

**Dosjet personale**

Në disa raste KPMK ka vërejtur se niveli i udhëheqjes, administrimit dhe mirëmbajtjes së dosjeve personale nuk përkon me standardet e kërkuara nga baza ligjore në fuqi. Në disa institucione është vërejtur se dosjet personale nuk mbahen në ambiente të sigurta, nuk anë të kompletuara me të dhënat personale dhe nuk freskohen në baza të rregullta për t'iu bashkangjitur ngritjen dhe zhvillimin profesional individual të nëpunësve civil.

**Trajnimet**

KPMK gjatë monitorimit të institucioneve ka vërejtur se planifikimi, programi dhe strategjia e trajnimeve të nëpunësve civil nuk është në nivelin e nevojave për trajnim dhe zhvillimit

profesional të personelit. Sa do që në sensin e aftësisht profesional Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) ka kryer një punë të mirë në trajnimin e stafit profesional në fushën e prokurimit dhe auditimit, por KPMK ka vërejtur se mungojnë trajnimet më të avancuara gjithëpërfshirëse sidomos për njohurit themelore mbi Ligjin e Shërbimit Civil dhe parimeve udhëheqëse në Shëmbimin Civil.

KPMK ka vërejtur se shumica e institucioneve si qendrore ashtu edhe ato lokale nuk kanë zbatuar plotësisht procedurat, ligjin dhe parimet mbi shërbimin civil. Me qëllim të përmirësimit KPMK, u ka dhënë rekomandime çdo institucioni ku janë vërejtur parregullsi dhe nevojës e domosdoshme për përmirësim. **(Shih shtojcën I)**

## XII. FUNKSIONI I VËZHIMIT

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës ka një funksion specifik e ky është vëzhgimi i procedurës së zgjedhjes së drejtorëve të Departamenteve në Shërbimin Civil të Kosovës, pra në të gjitha Ministrinë, Agjencitë Ekzekutive dhe Komunitatet e Kosovës.

Ky funksion është i paraparë me nenin 12 të Rregullores 2008/12, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 36/2001, për Shërbimin Civil të Kosovës. Në pajtim me dispozitën e përmendur, organet punëdhënëse në Shërbimin Civil të Kosovës, janë të obliguara që të njoftojnë Këshillin, për kohën e mbajtjes së intervistës, për plotësimin e vendeve të punës së drejtorëve të departamentit, që komisionit të caktuar për vëzhgim të KPMK-së duhet t'i paraqes tërë dokumentacionin e nevojshëm, lidhur me realizimin e konkursit për të cilin KPMK, është ftuar të marr pjesë në vëzhgim.

Gjatë ushtrimit të këtij funksioni, Këshilli, (me një komision tre anëtarësh), i ndihmuar me dokumentacion të nevojshëm, nga nëpunësi për vëzhgim i Sekretariatit, vërteton se a janë plotësuar kushtet për mbajtjen e intervistës, duke kontrolluar dosjen complete të rekrutimit, për rastin konkret e sidomos kopjen e konkursit të shpallur, përbërjen e komisionit intervistues duke u kujdesur që ai ti ketë përmbushur kriteret e parapara me nenin 7.2 të UA 2003/2, listën e kandidatëve që kanë konkurruar, mbarëvajtjen e intervistës dhe pas marrjes së raportit nga Organi punëdhënës, për zgjedhjen e kandidatit, vendos nëse kjo procedurë ka qenë në përputhje me parimet udhëheqëse të Shërbimit Civil të Kosovës.

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të vëzhgimit KPMK gjatë periudhës raportuese në autoritetet punëdhënëse ka realizuar 63 vëzhgime të zgjedhjes së 66 drejtorëve të Departamenteve dhe nivelit të njëjtë.

Përkundër rezultateve të arritura në vëzhgim dhe përmirësimet e dukshme në zbatimin e procedurave ligjore dhe parimeve të shërbimit civil, disa institucione nuk kanë respektuar rekomandimet rreth zgjedhjes së drejtorëve të departamenteve.

Ndonëse është obligim ligjor që me rastin e zgjedhjes së këtyre drejtorëve të marr pjesë si vëzhgues edhe komisioni i KPMK-së ka institucione të cilat nuk e kanë respektuar bazën ligjore, dhe kanë bërë zgjedhjen e drejtorëve te departamenteve, pa pjesëmarrjen e komisionit të KPMK-së.

Institucionet të cilat Këshilli i ka vëzhguar në zgjedhjen e personelit të lartë përmendur janë:  
Shih Tabelën në vijim:

Institucionet	Nr i Posteve	Titulli i pozitave	Vërejtje
<b>Administrata e Kuvendit të Kosovës</b>	1	- Drejtor i Administratës	
<b>ZKM</b>	2	- Drejtor i Auditimit -Drejtor i zyrës për shërbime dhe ndihmë juridike	
<b>MPJ</b>	4	-Drejtor i zyrës se auditimit, -Drejtor i zyrës se protokollit , -Drejtor i drejtorisë se auditimit te brendshëm, -Drejtor i zyrës për BE dhe NATO.	
<b>MKRS</b>	4	-Drejtor i Departamentit te Sportit -Drejtor i Dep. te Kulturës -Drejtor i Dep. te Administratës Qendrore -Drejtor i zyrës se prokurimit	
<b>MMPH</b>	2	-Drejtor i Departamentit te ujërave -Drejtor i njësisë se auditimit te brendshëm	
<b>MPMS</b>	3	-Drejtor Ekzekutiv i Financave -Drejtor i Departamentit te Institutit për Politika sociale -Drejtor i Departamentit te Prokurimit	
<b>MBPZHR</b>	4	-Drejtor i Departamentit të prokurimit, -Drejtor i Departamentit për Prodhime Fidanore, -Drejtor i Njësisë së Auditimit te Brendshëm, -Drejtor i Drejtorisë për silvikulturë dhe prodhime fidanore	
<b>MASHT</b>	1	-Drejtor i Departamentit për Financa dhe Personel	
<b>MEF</b>	4	-Drejtor i përgjithshëm i Buxhetit, -Drejtor i njësisë për buxhet Qendror, -Drejtor i njësisë për buxhet Komunal, -Drejtor i njësisë për politika dhe koordinim	
<b>MAPL</b>	1	-Drejtor i Departamentit për Administratë	
<b>MD</b>	2	-Drejtor Departamentit për Administrate dhe Personel -Drejtor Departamentit për Qasje ne Drejtësi	

<b>MPB</b>	5	-Drejtor i Departamentit për Siguri Publike -Drejtor i Departamentit për Emergjenca -Drejtor i Qendrës për Azilkërkues dhe pranimin e të huajve -Drejtor i Departamentit të Regjistrimit Civil dhe Gjendje Civile -Drejtor i zyrës për shtetësi	
<b>FSK</b>	10	-Drejtor i Departamentit të Prokurimit -Drejtor i Departamentit për Menaxhimin me Kontrata -Drejtor i Departamentit për Këshilla Ligjore -Drejtor i Departamentit të Logjistikes -Drejtor i Departamentit për Politika -dhe Plane -Drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun -Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Civilo- Ushtarak -Drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane -Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm -Drejtor i Departamentit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informimit	
<b>MEM</b>	2	-Drejtor i Departamentit të Energjisë -Drejtor i Departamentit për Strategji Standarde dhe Statistikë	
<b>MKK</b>	1	-Drejtori i Departamentit të Kthimit	Vëzhgimi është pezulluar nga KPMK, pasi që për këtë pozitë ka qenë e ushtruar ankese në KPMK nga punonjësi i cili më parë ishte në këtë pozitë.
<b>M. Shëndetësisë</b>	4	-Drejtor i Departamentit për buxhet dhe financa, -Drejtor i Departamentit për informim, -Kryeinspektor për Produkte dhe Pajisje Medicinave, -Drejtor Ekzekutiv i QKUK-së.	
<b>MTI</b>	2	-Drejtor i Departamentit ligjor, -Drejtor i Drejtorisë së Akreditimit	
<b>AKZHIE</b>	3	-Drejtor i Drejtorisë për Administratë -Drejtor i Drejtorisë për Qeverisje -Drejtor i Drejtorisë për zhvillim njerëzor dhe infrastrukturë	
<b>ASHAK</b>	3	-Drejtor i Departamentit të arkivave shtetërore të Kosovës, -Drejtor i Departamentit të Arkivave Komunale dhe Ndër komunale, -Drejtor i Departamentit për Planifikim ,Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar	Paraprakisht komisioni i KPMK-së ka dhënë rekomandime për rishpallje dhe plotësimin e kushteve ligjore për intervistim dhe përzgjedhjen përfundimtare.

<b>QKSPEZH</b>	2	-Udhëheqës i Administratës dhe Logjistikës, -Udhëheqës i Departamentit për Mbështetje Programore	
<b>Universiteti Prishtinës</b>	1	-Drejtor i Drejtorisë për Marrëdhënie me Jashtë	
<b>Qendra e Studenteve te UP</b>	1	-Drejtor i Qendrës se Studenteve	
<b>Gjykata Kushtetues e Kosovës</b>	4	-Drejtor i Departamentit për përkrahje Profesionale, -Drejtor i Administratës dhe burimeve njerëzore. -Drejtor i departamentit për buxhet dhe financa -Drejtor i departamentit për regjistrimin lendeve, statistikave dhe arkiv	
<b>Instituti i Avokatit të Popullit</b>	1	-Drejtor Ekzekutiv	
<b>K. Gjilan</b>	1	-Udhëheqës i personelit	
<b>K. Prizren</b>	1	-Udhëheqës i personelit	

### XIII. BUXHETI

KPMK ka bërë hartimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor, duke vlerësuar nevojat financiare për shpenzimet për vitin në vijim. Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Kosovës për KPMK-në, për vitin 2009, ka qenë 208.473.52 €, ndërsa i ndarë sipas kategorive ekonomike, në mënyrë tabelare duket kështu:

Nr.	Kategoritë Ekonomike	Buxheti i Aprovuar	Buxheti i rishit	Ndryshimi
1	Paga dhe mëditje	119.073. 52 €	119.073. 52 €	0.00
2	Mallra dhe shërbime	68.200.00 €	68.200.00 €	0.00
3	Shpenzime kapitale	16.500.00 €	16.500.00 €	0.00
4	Shpenzimet komunale	4.700.00 €	4.700.00 €	0.00
	<b>Totali</b>	<b>208.473.52 €</b>	<b>208.473.52 €</b>	<b>0.00</b>

*Tabela nr: Alokimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike*

#### 1. Mbikëqyrja e shpenzimeve

Gjatë vitit 2009, nga buxheti i miratur nga Kuvendi i Kosovës, KPMK ka realizuar 89.55% % të buxhetit të paraparë. Buxheti i ndarë për:

- Kategorinë **Paga dhe Meditje** është shpenzuar në masën 84.59% %. Kjo kategori nuk është realizuar në tërësi si rezultat i mos kompletimit të anëratëve të Këshillit.
- Kategorinë **Mallra dhe Shërbime** është shpenzuar 95.36% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori. Në tabelën e mëposhtme;
- Kategorinë **Shpenzimet e komunale** është shpenzuar në masën 98.53% % të buxhetit të planifikuar;
- Kategorinë **shpenzimet kapitale** është shpenzuar në masën 98.70% të buxhetit të planifikuar.

Këto të dhëna në mënyrë tabelare duken si më poshtë:

Nr.	Kodi buxhetor	Të aprovuara	Të shpenzuara	Të pa shfrytëzuar	Të shpenzuara %
1	<b>Paga dhe meditje</b>	119.073.52	100.719.65	18.353.87	84.59%
2	<b>Mallra dhe shërbime</b>	68.200.00	65.034.00	3.166.00	95.36%
3	<b>Shpenzimet komunale</b>	4.700.00	4.631.02	68.98	98.53%
4	<b>Shpenzime kapitale</b>	16.500.00	16.286.00	202.14	98.70%
	<b>Totali</b>	<b>208.473.52</b>	<b>186.682.53</b>	<b>21.790.99</b>	<b>89.55%</b>

Tabela nr: Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike

#### XIV. BASHKËPUNIMI

KPMK gjatë vitit raportues ka ngritur bazat e kultivimit të frymën së bashkëpunimit të mirë me disa institucione dhe organizata vendore e ndërkombëtare.

Një bashkëpunim të frytshëm KMPK ka pasur me misionin në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Kjo organizatë gjatë periudhës raportuese ka ndihmuar KPMK-në, në hartimin e draftit të parë të Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe në realizimin e një fushate vetëdijesimi për sensibilizimin e menaxherëve të institucioneve ashtu edhe të publikut në përgjithësi mbi funksionet e Këshillit dhe mundësitë që atyre u ofrohen për bashkëpunim.

Në këtë drejtim OSBE ndihmoi KPMK-në në realizimin e një spoti televiziv publicitar me qëllim të vetëdijesimit të nëpunësve civil për ofrimin e sigurisë juridike nga ana e Këshillit si dhe frymën bashkëpunuese në sensin kur ata besojnë se iu është bërë ndonjë padrejtësi lidhur me rregullat dhe parimet e shërbimit civil nga autoritete punëdhënëse.

Në këtë kuptim spoti i është ekspozuar edhe publikut të gjerë për t'iu dhënë informacion mbi funksionimin e Këshillit si dhe mundësinë që ata kanë të drejtë për t'iu drejtuar këtij organi në rastet kur ata besojnë se si aplikues për rekrutim në Shërbimin Civil iu është bërë e padrejtë dhe përzgjedhja është bërë në kundërshtim me parimin e meritës.

Kjo fushatë ka zgjatur një muaj dhe ka përfshirë edhe shpërndarjen e broshurave dhe posterëve të ndryshëm për rolin dhe kompetencat e këshillit.

### Vizitat studimore

Me qëllim të ngritjes profesionale dhe këmbimit të përvojave me organet analoge në rajon KPMK gjatë periudhës raportuese ka realizuar tri vizita studimore.

Me ftesë të Komisionit të Shërbimit Civil të shtetit Shqiptar, një delegacion i KPMK-së i përbërë nga anëtar të Këshillit dhe zyrtar të Sekretariatit u zhvillua një vizitë dy ditore në Komisionin e Shërbimit Civil në Tiranë.

Po ashtu me ftesë të Agjencisë për nëpunësit shtetëror të Maqedonisë, KPMK gjatë kësaj periudhe ka realizuar një vizitë studimore në Shkup. Edhe qëllimi i kësaj vizite ishte këmbimi i përvojave mes dy institucioneve homologe, ndërsa u dakordua që vizitat e ndërsjella edhe në të ardhmen do ndihmojnë në mas të madhe njëra tjetrën në ngritjen profesionale.

Me qëllim të ngritjes së bazave për bashkëpunim edhe me vendet që i takojnë Bashkimit Evropian me ndihmën e OSBE-së, KPMK ka realizuar një vizitë studimore në Budapest të Hungarisë për të shkëmbyer përvojat profesionale dhe mënyrës së funksionimit dhe punës praktike.

## **XV. PROBLEMET DHE VËSHITRËSITË**

Problemet dhe vështirësitë me të cilat është ballafaquar KMPK-ja gjatë periudhës raportuese mund të përmenden:

- Mos kompletimi i anëtarëve të Këshillit-(gjatë gjithë vitit raportues Këshilli nuk ka qenë i kompletuar me shtatë anëtarë ashtu siç e parasheh ligji);
- Numrin e madh të rasteve të bartura nga vitet paraprake;
- Mos ekzekutimi i vendimeve të KMPK-së nga ana e autoriteteve punëdhënëse, përkundër që kanë obligim ligjor ta bëjnë një gjë të tillë;
- Buxheti i pa mjaftueshëm, pasi që si rezultat i kësaj Sekretariati i KMPK-së, nuk ka mundur ta bëjë rekrutimin e stafit të nevojshëm i cili do të ndihmonte jashtëzakonisht shumë që Këshilli të zhvillojë një punë me efektive në terren për mbikëqyrjen e institucioneve, lidhur me respektimin e zbatimit të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës;
- Stimulim i pamjaftueshëm financiar anëtarët e Këshillit dhe stafin e sekretariatit;
- Mungesa e bashkëpunimit të nevojshëm me institucionet analoge të shteteve të ndryshme që do të mund të ti shërbente Këshillit në marrjen e përvojave të vendeve të BE-së për rolin dhe funksionimin e KPMK-së.
- Mungesa e hapësirës adekuate (objektit) për ushtrimin e veprimtarisë së KPMK-së.
- Inventar dhe pajisje elektronike tejet të vjetruara.

## XVI. SFIDAT E SË ARDHMES

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës do të përballlet me sfida të mëdha për kryerjen e funksioneve të veta gjatë vitit në vijim.

Fatkeqësisht ekziston mundësia që shumica e problemeve me të cilat KMPK është përballur gjatë vitin 2009 të barten edhe në vitin 2010, siç janë: mundësia e mos ekzekutimit të vendimeve të KPMK-së nga ana e autoriteteve punëdhënëse; buxheti i pa mjaftueshëm për të kompletuar gjithë stafin profesional të Sekretariatit për realizimin objektivave të KPMK-së; përmirësimin e kushteve dhe stimulimin e mjaftueshëm financiar për anëtarët e Këshillit dhe stafin e sekretariatit në nivelin e agjencive dhe institucioneve tjera të pavarura; mungesën e hapësirave adekuate për ushtrimin e veprimtarisë së KPMK-së etj.

Po ashtu KPMK do të përballlet edhe me sfida tjera pasi që pritet që gjatë vitin 2010 do të miratohen nga ana e Kuvendit edhe tri ligje të reja që direkt apo indirekt do lidhen me funksionet e KPMK-së.

Ligji mbi Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil është në procedurë amendamenti dhe pritet të aprovohet nga Kuvendi i Kosovës në gjysmën e parë të viti 2010. Në këtë drejtim KPMK-në krahas kryerjes së funksioneve aktuale e pret një aktivitet I shtuar për nxjerrjen e rregulloreve të brendshme dhe kodin etik të KPMK-së duke u mbështetur në ligjin në fjalë.

Po ashtu në rast se gjatë vitit 2010 do të aprovohet nga Kuvendi i Kosovës Ligji mbi Shërbimin Civil atëherë KPMK-së do ti shtohen obligime rreth mbikëqyrjes së zbatimit të tij nga institucione të ndryshme si autoritete punëdhënëse.

KPMK për vitin 2010 planifikon marrjen e masave për sensibilizimin e përgjegjësve të shërbimit civil nëpër autoritete punëdhënëse të të dy niveleve si atë qendrorë ashtu edhe atë lokal. Kjo do të bëhet për ngritjen e vetëdijes së tyre për domosdoshmërinë e ekzekutimit të vendimeve të KPMK-së duke u mbështetur në ligjin e ri për KPMK-në që pritet të miratohet nga Kuvendi gjatë vitit 2010 ku në pjesën e ekzekutimit të vendimeve parashihet të jetë tejet rigoroz.

Për të realizuar me sukses këtë objektiv KPMK ka pak kapacitete financiare, prandaj në këtë drejtim mund të përballemi me sfida që e rrezikojnë realizimin e këtij objekti.



## XVII. PËRFUNDIMI

Gjatë periudhës raportuese KPMK ka hasur në vështirësi të theksuara të cilat e kanë penguar këtë institucion për përmbushjen me përpikëri të tri funksioneve të cilat ia përcakton baza ligjore.

Përkundër vështirësive financiare, por edhe me mungesë të stafit profesional, KPMK gjatë vitit 2009 ka demonstruar përkushtimin dhe vendosmërinë për tu përballur me ankesat e nëpunësve civil dhe aplikuesëve, duke i zgjedhur edhe ankesat e bartura nga vitet paraprake.

Mos ekzekutimi vendimeve të KMPK-së nga ana e autoriteteve punëdhënëse ishte një brengë e madhe për KPMK-në.

Megjithatë shpresat e mëdha mbeten tek mundësia e kompletimit të infrastrukturës ligjore që pritet të ndodhë gjatë vitit 2010, aprovimi i Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ligji i KMPK-së i jep fuqi më të madhe vendimeve të Këshillit dhe obligon përfundimisht në mënyrë ligjore autoritetet punëdhënëse që të zbatojnë vendimet e marra nga ana e KMPK-së.

KMPK pret që me kompletimin dhe fuqizimin e infrastrukturës ligjore vendimet për ekzekutim dhe rekomandimet e Këshillit të mos mbeten vetëm si akte morale të zbatimit të tyre nga ana e institucioneve, por ato të merren si akte detyruese me që si të tilla i përcakton edhe vet ligji.

Përkushtimi i fuqishëm i KMPK-së vazhdon të mbetet sigurimi i një Shërbimi Civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të besueshëm dhe gjithmonë sipas parimeve dhe bazës ligjore të shërbimit civil.